



Pranuar / Doretuar Punëdhënësi/Prodator Received/Delivered	13.07.2023	3	vite god Year
Organ / Shërbim Organ / Jednica Org. Unit	Dr. Prof. Dr. Prof. Prof. No.	Shtojç / Prilog Appendix	Sasia Koliciteti Quantity
SKPM/SHK	5180/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.762/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.762/2023 të datës 19.05.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë pune në kundër Vendimit me numër XII-64 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit i datës 20.04.2023, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr. 762/2023 e datës 19.05.2023 e parashtruar nga ankuesja .

II.Shfuqizohet Vendimi me numër XII-64 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Obiliqit i datës 20.04.2023.

III.Obligohet Kryetari i Komunës së Obiliqit, që t'i ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e cili sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Komunën e Obiliqit, me datë 19.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil e cila është regjistruar me shenjën A.nr.762/2023 dhe numër protokoll:4349/2023, kundër Vendimit me numër XII-64 të Komisionit Disiplinor në Komunën e Obiliqit i datës 20.04.2023.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisionin Disiplinor me rastin e shqiptimi të masës disiplinore, ka bërë interpretim të gabueshmen dhe jo të plote të dispozitave ligjore dhe vërtetim jo të plote të provave materiale, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuseses si të bazuar, ndërsa të anulojë vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 20.04.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 23.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Obiliqit. Ndërsa me datën 26.05.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave për shqyrtimin e kësaj ankese administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4349/2023 të datës 19.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshill; Vendimi i lëshuar nga Komisioni Disiplinor me numër XII-64 i datës 20.04.2023; Vendimi i lëshuar nga Komisioni Disiplinor me numër XII-09 i datës 10.01.2023; E-mail i dërguar nga Prokurimi Obiliq drejtuar Krpp Mail i datës 21.09.2022; E-mail i dërguar nga drejtuar Prokurimi Obiliq i datës 02.10.2022; E-mail i dërguar nga Prokurimi Obiliq drejtuar Rregullat Krpp e datës 05.10.2022; Kërkesë për interpretim me numër XIII-343 e datës 05.10.2022; Përgjigje e kërkesës për interpretim e datës 11.10.2022; E-mail i dërguar nga ASHI-Support drejtuar A.A e datës 06.02.2023; Lista e Address Book; E-mail i dërguar nga Prokurimi Obiliq drejtuar OSHP e datës 19.10.2022; E-mail i dërguar nga XH.G drejtuar OSHP e datës 19.10.2022; Kërkesë me numër të referencës AKK-DLK-02-2849/22 e datës 23.08.2022; E-mail i dërguar nga Prokurimi Obiliq drejtuar akk hetimet e datës 25.08.2022; E-mail i dërguar nga SH.H drejtuar A.A e datës 01.09.2022; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore me numër AKK-02-2849/22 i datës 27.10.2022; Kërkesë për inicimin e procedurave të prokurimit me numër VIII-139 e datës 05.05.2022; Njoftim për Informata Shtesë ose Përmisim Gabimi me numër prot.OB614-22-2703-1-3-6 me korrespondencën e bashkangjitur; Raporti i Ekspertit Shqyrtues me numër të lëndës 281/22 e datës 03.08.2022; E-mail i dërguar nga A.A drejtuar A.M e datës 22.08.2022; Vendim i Panelit Shqyrtues P.SH.nr.281/22 i datës 16.08.2022; Krijimi i Komisionit të ri-vlerësimit të tenderit me numër XIII-236 i datës 16.08.2022; Vendim me numër XIII-229 i datës 15.08.2022; Vendim me numër II-1076 i datës 16.08.2022; Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 23.09.2022; Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm me nr.prot.OB614-22-5333-2-2-1 i datës 23.09.2022; Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm me nr.prot.OB614-22-5333-2-2-1 i datës 23.09.2022; Përgjigje mbi kërkesë për rishqyrtim me numër 04.10.2022; Certifikatë me numër 3507/2022 i datës 24.06.2022; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për B.I e datës 30.06.2022; Certifikatë e lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë për N.K e datës 27.06.2022; E-mail i dërguar nga A.T drejtuar A.A e datës 21.09.2022; Raporti i ekspertit shqyrtues me numër të lëndës 534/22 i datës 11.11.2022; Vendim i Panelit Shqyrtues P.SH.nr.534/22 i datës 07.12.2022; E-mail i dërguar nga A.A drejtuar XH.G e datës 14.10.2022; E-mail i dërguar nga XH.G drejtuar A.A e datës 21.10.2022; Kopja e Letërnjoftimit për A.A; Akt emërim i datës 07.05.2014; Akt emërim me numër 01.06.2015; Autorizim i datës 23.04.2022; Vendim me numër II-773 i datës 28.06.2022; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës A.nr.663/2022 i datës 22.09.2022; Kërkesë për pushim e datës 18.11.2022; Kërkesë për pushim e datës 29.04.2022; Fletë lëshimi për Epikriza i datës 04.08.2022; E-mail i dërguar nga A.A drejtuar A.M e datës 22.08.2022; Raport i ndërprerjes së përkohshme të punës i datës 07.07.2022; Raport mjekësor i datës 08.07.2022; Raporti Ristopatologjik/Citologjik me numër egzaminimi 7361/22; Fletë përcjellës për egzaminim histopatologjik dhe Citologjik; Email i dërguar nga XH.G drejtuar A.A e datës 18.10.2022; Kërkesë për heqje të autorizimit me numër XII-362 I DATËS 18.10.2022; E-mail i dërgua

nga XH.G drejtuar A.A e datës 20.10.2022; Kërkesë për fillimin ne procedurës disiplinore e datës 07.12.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 23.05.2023; Përgjigja në ankesë e datës 29.05.2023; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar E.H e datës 06.04.2023; Akt emërim për E.H e datës 10.04.2018; Akt emërim për B.M e datës 24.10.2022Akt emërim për L.H e datës 03.01.2013; Vendim mbi emërimin e komisionit i datës 20.11.2020; E-mail i dërguar nga L.U drejtuar A.M e datës 25.05.2023; Procesverbal i seancës Komisionit disiplinor i datës 07.04.2023; Procesverbal i Komisionit disiplinor i datës 12.04.2023; Procesverbal i Komisionit disiplinor i datës 20.04.2023; E-mail i dërguar nga A.T drejtuar A.A e datës 21.10.2022; E-mail i dërguar nga L.H drejtuar L.U e datës 12.04.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar XH.G e datës 09.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar A.A e datës 09.12.2022; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 12.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar A.A e datës 12.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar XH.G e datës 12.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar E.H i datës 15.12.2022; Procesverbal i seancës së Komisionit Disiplinor i datës 20.12.2022; Përgjigje me numër II-1601 i datës 17.11.2022; Procesverbal i Komisionit disiplinor i datës 16.12.2022; E-mail i dërguar nga A.M drejtuar SH.H e datës 20.12.2022; E-mail i dërguar nga L.H drejtuar A.A e datës 16.12.2022; Procesverbal i Komisionit disiplinor i datës 22.12.2022; E-mail i dërguar nga A.A drejtuar XH.G e datës 05.08.2022; Marrëveshje për kryerjen e punëve të përkohshme shtesë në komunën e Obiliqit në shërbimin civil me numër II-1463 i datës 21.10.2022; Vendimi për kryerjen e punëve të përkohshme shtesë në komunën e Obiliqit në shërbimin civil me numër II-1466 i datës 24.10.2022; E-mail i dërguar nga S.H drejtuar A.M e datës 23.12.2022; Autorizim me numër II-85 i datës 09.02.2022; Autorizim me numër II-381 i datës 21.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e bazuar, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja Arta Alaj sipas Aktit të Emërimit të datës 01.06.2015 mban pozitën e punës “Zyrtar i Lartë i Prokurimit” në kuadër të Komunës së Obiliqit, ndërsa Kryetari i Komunës së Obiliqit me datë 21.04.2022 përmes autorizimit me shifër: II/381 e ka ngarkuar të njëjtën që t’i kryej detyrat dhe përgjegjësit e Menaxheres së Prokurimit dhe atë duke filluar nga data 21.04.2022 e deri në momentin e zgjedhjes së Menaxherit të Prokurimit. Ndërsa pas kërkesës së datës 09.12.2022 për inicimit e procedurës disiplinore nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë, Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër XII-09 të datës 10.01.2023, kishte konstatuar se ankuesja ka bërë shkelje të përcaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe si rrjedhojë të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore “Ndalim nga 20% të pagës për periudhën kohore prej katër (4) muaj”.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja Arta Alaj kishte parashtruar ankesë e regjistruar me shenjen A.nr.331/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 07.02.2023 kundër Vendimit të Komisionit Disiplinor me numër XII-09 të datës 10.01.2023, ndaj të cilit, Këshilli pas shqyrtimit të ankesës ka anuluar Vendimin e Komisionit Disiplinorë dhe ka kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje.

Tutje, me qëllim të zbatimit të Vendimit të Këshillit, Komisioni Disiplinor përmes Vendimit XII-64 të datës 20.04.2023 ka aprovuar pjesërisht kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore të udhëheqësit të drejtpërdrejtë, ashtu që për shkak të shkeljeve të përcaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ankueses i ka shqiptuar

masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës për periudhën kohore prej katër (4) muaj" me arsyetimin se ankuesja është përgjegjës për tre (3) rastet si në vijim: (1. KRPP-Prokurimi Obiliq, 2. OSHP-Prokurimi Obiliq, dhe APK Prokurimi Obiliq) nga gjithsejtë katër (4) rastet e paraqitura si shkelje të rënda e detyrave të punës me rastin e inicimit të procedurës disiplinore nga Kryetari i Komunës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses ndërlidhur me arsyetimin e vendimmarrjes nga ana e Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 45 dhe të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit" si dhe nenin 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 i të njëjtit ligj që përcakton se: "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; dhe 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. Mos përmbushja e detyrave të punës, dhe ka arritur në përfundimin se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të jetë bindës në arsyetimin e bërë në Vendimin me numër XII-64 të datës 20.04.2023, përmes të cilit ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës për periudhën kohore prej katër (4) muaj", dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ngase elementet e përgjegjësive disiplinore duhet të vlerësohen vetëm nëse të njëjtat janë konsumuar në mënyrë kumulative, kurse Komisioni Disiplinor në arsyetimin e Vendimit nuk ka arritur të bind se cilat veprime të ankueses kanë shkaktuar pasoja apo dëme materiale ndaj institucionit, cila është lidhja shkakore mes veprimit të ankueses dhe pasojës, si dhe cilat veprime apo mosveprime janë shkaktuar me faj të ankueses.

Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Këshilli përmes Vendimit A.nr.331/2023 ka udhëzuar Komisionin Disiplinor të Komunës që me rastin e rishqyrtimit dhe të rivendosjes së lëndës disiplinore të ankueses duhet të ketë parasysh vërejtjet e dhëna në arsyetimin dhe duhet të shqyrtojë pretendimet e ankueses e cila në provat e bashkangjitura me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka ofruar dëshmi nga ASHI lidhur me validitetin e e-mailit zyrtar KRPP MALL që ndërlidhet me pikë një (1) të inicimit të procedurës disiplinore, ndërsa Komisioni Disiplinor edhe pse i është drejtuar Komisionit Rregullativ për Prokurimin Publik për informacione shtesë lidhur me funksionalizimin e e-mailit në fjalë, e njëjta deri në marrjen e vendimit thekson se nuk ka marrë përgjigje, mirëpo ankuesen me veprimet e saj e kanë gjetur përgjegjëse për dëmin e shkaktuar citoj: "ku kemi pasur humbje të kohës", Këshilli konstaton se ankuesja me veprimet e saj nuk ka bërë anashkalim të detyrave të punës duke marrë parasysh se e njëjta procedimin e kërkesës për interpretim e ka bërë në njërën nga e-mailat zyrtar të KRPP-së dhe një gjë e tillë e përjashton ankuesen nga përgjegjësia për mos përmbushje të detyrave të punës, njëkohësisht dëmi të cilin Komisioni Disiplinor pretendon se ankuesja e ka shkaktuar nuk paraqet dëm material, respektivisht Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të bëjë ndërlidhjen në mes humbjes së kohës sikurse pretendojnë dhe ndodhjes së pasojës apo dëmit të shkaktuar.

Po ashtu, Këshilli konstaton se sa i përket pikës dy (2)-mungesën e dërgesës së përgjigjes apo vonesës sipas kërkesës së OSHP lidhur me provat e kërkuara, Komisioni Disiplinor është dashur të ketë parasysh e-mailin e datës 17.10.2022 dërguar nga OSHP për Prokurim Obiliq, e që në përmbajtjen e së cilës nuk është paraqitur ndonjë afat specifik apo të përcaktuar kohor brenda të cilës ankuesja ka qenë e obliguar t'i kthej përgjigje OSHP-së, si dhe e-mailin e datës 19.10.2022 të dërguar nga Prokurimi Obiliq drejtuar OSHP mbi përgjigjen ndaj kërkesës, nga rrjedh fakti se



ankuesja me veprimin apo mosveprimin e saj nuk ka shkaktuar dëm duke marrë parasysh se e njëjta i është përgjigjur kërkesës së OSHP-së, e po ashtu Komisioni Disiplinor në arsyetimin e vendimit thekson se citoj: "..... rrjedhimisht dëmi do të ishte në anulimin e tërësishëm ose në aprovimin e ankesës nga ana e OE nga ana e OSHP-së", andaj nga vet fakti se asnjë dëm nuk është shkaktuar ankuesja nuk mund të bartë përgjegjësi disiplinore për moszbatimi apo zbatim jo të duhur të detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore duke marrë parasysh që nuk janë përmbushur elementet ligjore të përcaktuar me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik. Sa i përket pikës tre (3) të kërkesës, Këshilli konstaton se hetimi i lëndës nga Agjencia kundër Korrupsionit dhe moskthimi i përgjigjes me kohë ndaj kërkesës së AKK nuk përmbush elementet e përgjegjësive disiplinore për të cilën ankuesja duhet të bartë përgjegjësi marrë parasysh se Komisioni Disiplinor vet ka konstatuar se ankuesja asnjëherë nuk ka pranuar kërkesën nga Agjencisë Kundër Korrupsionit me nr.03/03-2143/2022 të datës 20.05.2022, andaj Komisioni Disiplinor nuk mund ta mbaj përgjegjëse ankuesen për mos përmbushje të detyrave nëse e njëjta nuk ka pranuar një kërkesë ndaj të cilës është dashur të përgjigjet.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ekzistojnë arsyet të mjaftueshme që ankesa e ankueses të aprovohet kurse Vendimi i Komisionit Disiplinor me numër XII-64 i datës 20.04.2023 të anulohet pasi që i njëjti nuk ka arritur të vërtetoj se ankuesja me veprimet e saj ka arritur të përmbush elementet e përgjegjësive disiplinore të përcaktuar edhe me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik pasi që veprimet apo mosveprimet e ankueses të përshkruara si më lartë nuk paraqesin dëm material ndaj institucionit dhe nuk janë bazë e mjaftueshme që ankueses ti shqiptohet masë disiplinore.

Po ashtu Komisioni disiplinor gjatë nxjerrjes së Vendimit me numër XII-64 nuk ka zbatuar drejtë parimet e individualizimit të masave disiplinore, ngase ankuesja sipas shkresave të lëndës rezulton se nuk ka masë tjetër disiplinore aktive, andaj Komisioni ka vepruar në kundërshtim me neni 50 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: 1. *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përprjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.*", andaj në rrethanat e rastit konkret Kolegji i Këshillit vlerëson se mënyra e zhvillimit të procedurës disiplinore deri tek arritja e konstatimeve se ankuesja ka kryer shkelje të rënda të punës nga ana e Komisionit Disiplinor është bërë në kundërshtim edhe me parimet e përgjithshme sikurse përcaktohet me nenin 7 paragrafi 1 të ligjit material, gjegjësisht ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "*Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë.*", ngase Komisioni Disiplinor gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore nuk kishte përbazë as gjendjen shëndetësore të ankueses për të cilën e njëjta e ka vërtetuar me prova materiale gjatë asaj kohe.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur i cili pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.762/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Malsore GASHI BAJRAJTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Komunën e Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.